



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 4617/3 prot.

Himarë, më 24.10.2023

PROCESVERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

PËR

“Dëgjese publike me banorët e njësisë Hor-Vranisht për projektbuxhetin e vitit 2024”

Njësia administrative	Data	Ora	Vendi ku zhvillohet dëgjesa	Struktura organizatore
Hor-Vranisht	24.10.2022	10.00	Pranë Njësisë Administrative	Drejtoria e financës, e planifikimit të buxhetit dhe e integritimit evropian

PJESËMARRJA

Nga Bashkia Himarë	Nga komuniteti	
Nënkryetari-Z.Pervin Gjiguria Nënkryetari-Znj.Blerina Bala	Lista me pjesëmarrës bashkëngjitur	
Drejtori i drejtorisë së financës, të planifikimit të buxhetit dhe të integritimit evropian-Z.Laert Mezani	_____	_____
Administratori i Njësisë-Z.Gramos Balilaj Drejtor i ujësjellësit Himarë-Z.Andrea Goro	_____	_____
Specialistë të financës dhe të buxhetit të Bashkisë Himarë.	_____	_____
Kryetar Këshili Bashkiak- Z.Dhimitër Kapaj Sekretare Këshilli Bashkiak-znj.Elena Memushaj	_____	_____
Këshilltar Bashkiak-Z.Timoleo Gërdhuqi Kryetarët e fshatrave	_____	_____

Të tjerë Deputet-z.Vullnet Sinaj		
-------------------------------------	--	--

- **Tematika për diskutim:**

1. Hartimi i paketës fiskale për vitin 2024
2. Problematika të hasura gjatë vitit 2023 me mbledhjen e taksave
3. Përshkrim i të ardhurave që do të jenë në dispozicion për parashikimin e investimeve
4. Sfidat që paraqiten në vjelje të taksave vjetore
5. Propozimet nga banorët e njëjësive.
5. Të tjera

- **Zhvillimi i dëgjësës**

1. U bë i qartë për pjesëmarrësit qëllimi i thirrjes për dëgjësë publike nga drejtori i drejtorisë së financës , z.Laert Mezani.
2. U vunë në pah probleme të evidentuara në territorin e bashkisë Himarë, të lidhura me nevojën për investime, gjatë viteve të fundit.
3. U sqarua dhe u argumentua në vija të përgjithshme rreth tarifave të parashikuara për paketën fiskale për vitin 2024.
4. U kalua në pyetje nga të pranishmit e në diskutime rreth projektbuxhetit dhe paketës fiskale për vitin 2024:

Fjala hyrëse

Dhimitër Kapaj- Dëgjesa për buxhetin e vitit 2024.

Këshilli ka bërë mbledhje për problematikat. Kemi pjesë Bashkia dhe Këshilli. Janë monitoruar projekte dhe janë reduktuar diku te 50%. Projektet që janë bërë kanë disa problem si ujësjellësi i Vranishtit, ujit Kuçit etj. Ju faleminderit.

Laert Mezani- E kemi të përvitshëm këtë takim për të marrë kërkesat. Ne si panel nuk jemi për të fol cfarë është bërë por për prioritet për vitin 2024. Qëllimi I pjesëmarrjes nga komuniteti është që të orientohen investimet. Në përfundim të diskutimeve buxheti do marrë rëndësi sipas prioritetit. Kërkesa për ndalimin e erozionit në tokat bujqësore. Të ardhurat nuk kanë ndryshuar, niveli i taksimit mbi tokat përsëri jo. Është trend largimi I banorëve, rikonstruksion I rrugëve,shkollave. Cfarë duhet të bëjmë për kthimin e atyre personave të cilët janë larguar?

Dhimitër Kapaj- Problemi I ujësjellësave kujt do ti drejtohem.

Laert Mezani-Ujësjetllësi është në drejtim të bashkisë. Kalimi në drejtim të qeverisë bëhet për arsye lehtësie investimi.

Dhimitër Kapaj- Nëse kanë të drejtë të kërkojnë shpenzime për ujësjellësin?

Fiqiri Rexhepaj- A janë kaluar pagesat për ujësjellësin e Vranishtit?

Dhimitër Kapaj- Bashkisë I është heqë e drejta për investim në ujësjellës.

Laert Mezani- Nuk largohet asnjë nga përgjegjësia për këta ujësjellës.

Deputet i zonës Z.Vullnet Sinaj- Të dëgjojmë njerëzit.

Simo Ribaj- Ju falenderoj, jemi mbas një viti. Shikojmë që nuk është bërë asgjë.Për Vranishtin prioritet është rruga dhe qendra e fshatit. Pastrimi i lagjes lart që përfshihet në turizëm malor. Përse pritet energjia elektrike? Përse shërbimi I ujësjellësit është përkeqësuar? Përse TVSH nuk funksionon? Përse kemi mesazhe nga kompani celulare greke? Përse keni lënë qendrën e fshatit pa investuar? Përse ushtrojnë aktivitet gurore te paligjshme? Përse nuk vendosni disa kazanë në krye të fshatit? Përse ju merrni ujin e lumit këtyre banorëve? Te gjitha këto na cojnë në shkombëtarizim dhe shplopullim.

Dhimitër Kapaj- Probleme të mesazheve sjanë problemet tona.

Laert Mezani- Të gjithë do flasin, kërkesa, kritika. Problemi I antenës ndodh që kanë akses stacione të huaja apo sinjale telefonike celulare. Pavarësisht ngjyrimit kombëtar ky është një problem.Kompanitë celulare kanë mungesë në mbulim dhe ne kemi bërë kërkesë për shtesë të antenave. TVSH duhet të detyrojë AMA për mbulim 100% me sinjal. Janë bërë të gjitha përpjekjet për të shtuar antenna.

Lefter Qejvanaj- Para një viti jam çuar dhe kam fol, është fol për një punishte qumështi. Prioriteti im ka qenë mbrojtja e tokës, ujësjellës, uji vaditës etj. Nuk është bërë asgjë nga këto. Ka 2 vjet nuk është hedh asnjë qindarkë.

Adnant Barjamaj-Fashti Tërbaç është presekutuar për problemin e tokave bujqësore pasi kanë ngelë pa rrugë për mjetet. Është kërkuar rruga është kërkuar dëmshpërbimi nga ARSH. Ne presim të na thoni se çfarë është bërë. Të gjithë kërkojmë investime. Tokën na I merr lumi, diku ska ujësjellës për të ujitur.Problemet e energjisë elektike është flagrant. Mbeturinat, shërbimi, koshat, mungojnë.Shërbimi I pastrimit mungon. Shkoj e blej një ball jonxhe 8 mij lekë të vjetra. Punoj me turistë dhe me vjën turp kur shikoj lumenj plot mbeturina.

Bektash Bashaj- Prioritet qendra e fshatit Vranisht.Rrugët e lagjeve dhe burimi I Vurgjidhit. Ju drejtohem ju zoti deputet Vullnet Sinaj për problemin e dritave. Kërkojmë shërbim për ambulanc. A është marrë në dorëzim ujësjellësi I fshatit Vranisht? Si janë firmos kur ne skemi ujë?

Astrit Balilaj-Kryetar I ri I fshatit Kuç. Raporti I investimeve çfarë metodike përdoret, përzgjedhja e prioriteteve.Prioritet e Kuçit për vitet në vazhdim. E para është moscenimi I pasurive të komunitetit,pyje,male,gur, uji I Lepushës. Ujësjetllësi I fshatit Kuç nuk funksionon. Në çfarë faze është dhe ku ka ngeç puna? Problemet dhe prioritetet do ti mbledhim dhe do ti dërgojmë në Bashki dhe në

Këshill. Rrjeti energjisë është shumë I amortizuar dhe na sjell vazhdimisht problem. Ju lutem mbani qëndrim për ujësjellësin e Himarës.

Petrit Gjikonci-Ju falenderoj port ë na kishit sjellë atë çfarë është bërë nga prioritet e vitit të kaluar. Dy problem kam unë për fshatin Vranisht. Problemi I rrugës së këtij fshati është detyrim.Ujësjellësi I fshait Vranishit nuk ka përmirësuar asgjë. Qendra e fshatit që është shkatëruar. Mوندohemi ta pastrojmë por është e vështirë. Të mos kesh drita në vitin 2023 është shumë e rëndë.Problemi I ujit të Lepushës duhet me shumë kujdes. Problemet e guroveve çfarë detyrimesh kanë këto kompani për kthmin e tyre në gjendjen e mëparëshme.

Dhimitër Kapaj-Rrugët e fshatrave Vranisht dhe Tërbaç janë çuar në oponencë në të gjitha etapat e ezauruara. Nuk ka asnjë lëvizje nga Qeveria , FSHZH.

Shkëlqim Hodoj-Problem kryesor mbete rruga.Ndriçimi dhe pastrimi nuk ka asnjë shërbim.Lagjia Lekaj kërkon rrethimin e varrezave.

Muhamet Alikaj i përfaqësuesi i fshatit Bolenë kanë këto kërkesa:

Ujësjellësi i fshatit Bolenë të merret me rredhje të lirë. Rruga e Bolenës kërkon mirëmbajtje pasi po dëmtohet. Godina për pleqësin dhe për shërbime shëndetësore. Kanal vaditës për një lagje. Kërkesë për një urë për njerëz dhe makina. Shpërndarja e ujësjellësit Hund e Xhepe kërkon riparim. Ju faleminderit.

Asllan Lalaj- Kur lidhet ujësjellësi I fshatit Kuç?

Arjanit Toçaj- Shikoni infrastrukturën.

Petrit Begaj- Punoj në OSHEE. Po bëhen remonde të përgjithshme.Nuk përballohen dot pasi ka shumë nevojë.Njerëzit kanë të drejtë që kërkojnë por kaq janë mundësitë.

Fiqiri Rexhepaj- Tokat shtet janë rrethuar.

Këshilltari bashkiak Timoleo Gërdhuqi- Përsëndje jam nënkryetar këshilli, ka disnivele në gjendjen e zonës por duhet të bëhen investime në të gjithë territorin. Ju duhet të bëni kërkesa në mënyrën e duhur dhe në vendin e duhur. Ka mungesë të personave që janë përgjegjës për këto drejtime. Kryesitë e fshatrave të bëjnë kërkesë të sportelet dhe në dijeni të Këshillit Bashkiak. Pa projekte nuk ka investime. Po nuk u bënë projekte nuk ka asnjë qindarkë. Opozita do ngre komision hetimor për investimet e bëra. Dua që në këtë njësi të bëhen investime. Shpërndarja e lekëve të jetë e barabartë.

Laert Mezani-Konslutimet janë të rëndësishme, kanë seriozitet.Punë dhe projekte janë bërë.

Astrit Balilaj-A bëhet qymyr në fshatin Kuç në dijenin tuaj?

Laert Mezani-Njësia ka punonjës të zyrës pyje dhe kullota dhe flasin. Ka kërkesa të tjera? Jo

Deputet i zonës Z.Vullnet Sinaj- Përgëzoj kërkesat për investime në zonë.Qëllimi I kësaj mbledhje është të dëgjojmë kërkesat e banorëve. Do ju kërkojmë llogari pse sjanë bërë investime.Ujësjellësi I Vranishit nuk funksionon siç duhet.Përgjegjësitë janë të abuzuesve. Do jëmi palë për të çuar deri në fund cilësinë e punimeve. Unë si deputet marr përgjegjësitë për të ndjek problemet. Problemi I ujësjellësit të Himarës investim I kaluar në vitin 2019 por që duhet parë nevojat e para të komunitetit. Kam kërkuar infomacion

nga Bashkia, FSHZH dhe KFV mbi këtë investim. Jemi me pak vonesë por do të këmbëngulim për këtë punë. Bashkitë e vogla të bjënë një buxhet afatgjatë. Kërkesat e kryesive të çohen në panel më shkrim. Financimet të bëhen në bazë të buxheteve afatgjatë. Për politikë? I dashur opozitar çfarë ka bërë opozita për këtë komunitet gjatë gjithë qeverisjes së saj në të gjitha kohërat? Asgjë ska bërë. Investime ka të gjithë territorin. Rrugët janë shumë të rëndësishme. Fshatrat e kanë problem pjesën e rrugëve të brendëshme. Jam krenar për këtë zonë shpresoj që Bashkia të bëjë project afatgjatë. Ju faleminderit që më dëgjuat.

Administratori Gramos Balilaj- Ju falenderoj, kam disa gjëra edhe unë. Ju falenderoj për çfarë janë bërë. Ujës-jellësi Vurgjith duhet të bëhet. Problemi I ujit të Qafës Ubavit Kallarat ka nevojë për ndërhyrje flagrante. Shpërndarja e jrit të lagjes Hundë Xhepe Bolenë. Për Kuçin sdua të flas por problem I ujit është jashtë funksionit totalisht. Të testohet për ta parë a do të funksionojë. Një pjesë nuk është përfshirë fare në projekt. Të gjitha prioritet e fshatrave janë cuar dhe tju bëhem projekte. Bashkia ka të drejtë të ndërhyj në rrugët rurale. Deputetit do ti kërkoja për rrugët të ndikojë me mundësitë e tij. Problemi I ujit të Lepushës, kërkoj komision për matje të sasisë së prurjes.

Deputet i zonës Z.Vullnet Sinaj-Kam kërkuar studimin e burimit nga KFV. Nuk kam marrë përgjigje.

- **Mbyllja**

U falënderuan pjesëmarrësit. U mblodhën nënshkrimet e pjesëmarrësve. U bë mbyllja e takimit.

MBAJTËS TE PROCESVERBALIT

SPECIALISTI I TRANSPARENCËS DHE I KOSULTIMIT PUBLIK

Erind Habili

SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK

Elena Memushaj

Foto nga dëgjesa publike Njësia Administrative Hor-Vranisht më datë 24.10.2023







REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA HIMARË

Data 24.10.2023

Listeprezenca

Dëgjesa publike Njësia Hor-Vranisht Paketa Fiskale dhe Buxheti e viti 2024
Bashkia Himarë

Nr	Emër Mbiemër	Qyteti/Fashti	Firma
1	Edat Haxhiu	Vranisht	[Signature]
2	Simo Kibaj	Vranisht	[Signature]
3	Albi Sinaj	Terbac	AS
4	Elonis Shqipaj	Terbac	[Signature]
5	Helbert Haki	Caj Tejtak	[Signature]
6	Rashan Shqipaj	Terbac	[Signature]
7	Ilir Shqipaj	Terbac	[Signature]
8	Admand Krasni	Terbac	[Signature]
9	Ilmird Mullaj	Boles	[Signature]
10	Gjergj Tomaj	Caj Tejtak	[Signature]
11	Skender Mami	Kufi	[Signature]
12	Arbeni Faj	Kufi	[Signature]
13	Asjant Buleaj	Kise	[Signature]
14	Lebler Agaj	Kelle	[Signature]
15	Bashkim Davaca		BD
16	Muhamed Ali	Boles	[Signature]
17	Viktor Radoja	Kufi	[Signature]
18	Selman Mami	Boles	[Signature]

Adresa:Rr."25 Marsi", Nr.2, Spile,Himarë web:www.himara.gov.al E-mail: info@himara.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA HIMARË

Data 24.10.2023

Listeprezenca

Dëgjesa publike Njësia Hor-Vranisht Paketa Fiskale dhe Buxheti e viti 2024
Bashkia Himarë

Nr	Emër Mbiemër	Qyteti/Fashti	Firma
1	Eqerzet	Gjilkaudi	[Signature]
2	Calisabeta	Scenuq	[Signature]
3	Gnamis	Balila	[Signature]
4	Laimleo	Gerchaj	[Signature]
5	Davit	Krasaj	[Signature]
6	Isa Mami	Kufi	[Signature]
7	Ilir Shqipaj	Terbac	[Signature]
8	Isabel Topaj	Terbac	[Signature]
9	Elona	Memushaj	[Signature]
10	FRIDA NABILI		[Signature]
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			

Adresa:Rr."25 Marsi", Nr.2, Spile,Himarë web:www.himara.gov.al E-mail: info@himara.gov.al

19	Mame Mami	KUC	[Signature] 010 24.10.23
20	Asllan Kufi	KUC	[Signature]
21	Bashkim Mami	Vranisht	[Signature]
22	Lebler Agaj	Terbac	[Signature]
23	Silkegim Haki	Terbac	[Signature]
24	Bashkim Mami	Terbac	[Signature]
25	Fisri D. Paschupi	Vranisht	[Signature]
26	Arbeni Faj	Kufi	[Signature]
27	Ramado Mami	Vranisht	[Signature]
28	Qeta Vekaj	Boles	[Signature]
29	Deli Arshaj	Terbac	[Signature]
30	Mihal Gjokaj	Terbac	[Signature]
31	Aradin Shkodi	Vranisht	[Signature]
32	Bajram Shqipaj	Terbac	[Signature]
33	Arbeni Faj	Boles	[Signature]
34	Arbeni Faj	Terbac	[Signature]
35	Jani Gani	Vranisht	[Signature]
36	Ilir Shqipaj	Kufi	[Signature]
37	Edlira Venaj	Vranisht	[Signature]
38	Eliona Cacaj	Boles	[Signature]
39	Valbona Strataj	Boles	[Signature]
40	Lumtur Sadika	Boles	[Signature]
41	Enxheta Malaj	Boles	[Signature]
42	Blarina Bala	N/Kryetar B. Himarë	[Signature]
43	Shyqyret Gjilkaudi	Boles	[Signature]

Adresa:Rr."25 Marsi", Nr.2, Spile,Himarë web:www.himara.gov.al E-mail: info@himara.gov.al

